



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:247296

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05568059

C-IV-14-5394

Ankuesi

Xh Sh, Prishtinë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me datë 12 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN124-2404, i datës 23 qershor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 15 korrik 2014, ankuesi ka parashtruar në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN124-2404, të datës 23 qershor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të punës, në shumë prej 1,083.16 € nga NSH “Sloga” KHT “Kosova” (në likuidim). Ankuesi ka pohuar se ka qenë i punësuar në “KHT Kosova”. Po ashtu ankuesi pohoi se ne vendimin e AL për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës i është refuzuar kërkesa me arsyetimin se gjoja ka punuar në një ndërmarrje që për të është fantome dhe e pa qenë ngase për herë të parë po dëgjon për këtë ndërmarrje të quajtur “New CO”. Sipas ankuesit është bërë ndonjë gabim pasi që ai asnjëherë nuk ka qenë i punësuar në këtë

ndërmarrje të panjohur dhe asnjëherë nuk ka punuar në ndonjë kompani tjetër përveç në KHT “Kosova”. Në mbështetje të ankesës, ka dorëzuar kopjen e vendimit të kundërshtuar, kopjen e njoftimit të datës 01 gusht 2006 dhe kopjen e letërnjoftimit.

Me 03 prill 2023, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Po ashtu AKP-ja pohoi se ankuesit marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë, përkundrazi ajo ka vazhduar me New CO prandaj veprimi i AKP ka pasur si pasojë vazhdimin e marrëdhënies së punës, jo ndërprerjen e saj, për këtë arsye ankuesi nuk gëzon të drejtën të përfitojë dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës sepse ai nuk i përmbush kushtet ligjore të parapara nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (më tej Ligji Themelor i Punës), i zbatueshëm në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mes të ankuesit dhe AKP-së, parasheh:

Kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje. Ndryshimet e tilla paraqesin rastet kur punëdhënësi bën ndryshime në prodhim, në programim, në organizim, në strukturë dhe në teknologji të cilat kërkojnë zvogëlim të numrit të punonjësve. Në rastet kur për këtë arsye largohen nga puna të paktën 50 punonjës konsiderohet se largimi nga puna është i shkallës së gjerë.

Neni 12.2 i Ligjit Themelor të Punës parasheh: ‘Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t’i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;

- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore dhe

Neni 12.3 i Ligjit në fjalë përcakton se:

Rastet kur punonjësit e larguar nga puna për shkak të falimentimit dhe riorganizimit të administruar nga gjykata nuk i nënshtrohen dispozitave të kësaj rregulloreje.

Gjykata me kujdes ka shqyrtuar pretendimet e palëve në këtë çështje dhe vendimin e kundërshtuar. Në këtë drejtim, vendimi i AKP-së thekson se parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar nga Ndërmarrja e Re në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Angazhimeve. Prandaj, ndryshe nga të qenurit tepriçë e fuqisë punëtore, pas privatizimit, parashtruesi ka vazhduar marrëdhënien e tij të punës me Ndërmarrjen e Re sipas nenit 3.1 të Marrëveshjes në fjalë, pjesë e privatizimit me spin-off special të NSH KHT "Kosova". Ankuesi vetëm ka pohuar se asnjëherë nuk ka punuar në ndonjë kompani tjetër, por fakti i vazhdimit të marrëdhënies së punës ndërmjet ankuesit dhe Ndërmarrjes së Re pohohet nga e paditura se ka vazhduar pas vitit 2006, i cili fakt nuk është kontestuar nga ankuesi dhe kështu gjykata e konsideron atë si një fakt të pakontestueshëm.

Gjykata nuk është e mendimit se dëmshpërblimi jepet si kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të punësimit, sepse te punësimi me kohë të pacaktuar, nuk mund të flasim për ndërprerje të parakohshme, por me tepër si një përfitim social i përcaktuar me ligj me qëllim sigurimin e mjeteve për mbijetesë për familjet e të papunëve. Në këtë rast specifik, ankuesi është pranuar në punë menjëherë nga Ndërmarrja e Re, si një obligim nga marrëveshja që AKP-ja e ka pasur me blerësin e NSH-së, kështu duke mos lënë zbrazëtirë për ankuesin në mes të punësimit të mëhershëm dhe të riut. Kështu, nuk ka lëshim nga ana e AKP-së që do të mund të arsyetonte pagesën pas largimit nga puna. Gjykata konsideron se vetëm kategoria e punëtorëve që nuk janë marrë në punë nga Ndërmarrja e Re mund të shqyrtohet për të drejtën e dëmshpërblimit dhe ankuesi i përket kategorisë tjetër.

Edhe në qoftë se ne, e konsiderojmë të drejtën për dëmshpërblim si një përmbushje (kompensim) për ndërprerje të parakohshme të një kontrate për marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar e jo si përfitim social, baza e ekzistencës e kësaj të drejte duhet të jetë dëmi financiar që u shkaktohet punëtorëve që e kanë humbur punën-dëmin që parashihet me ligj. Por ky supozim nuk është absolut dhe mund të kundërshtohet me dispozitën e dëshmime kundërshtuese. Në rastin në fjalë pohohet nga e paditura se ankuesi ishte marrë në punë nga Ndërmarrja e Re dhe kjo është saktësisht dëshmi e tillë kundërshtuese që mbështet konkluzionin se ankuesi nuk ka pësuar asnjë dëm dhe si e tillë, është arsye për refuzim nga gjykata të prezumimit ligjor.

Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së (C-IV-13-0193, C-IV-13-0366, C-IV-13-0493 dhe AC-I-14-0134) për refuzimin e ankesave për dëmshpërblim nga shkëputja e parakohshme e kontratës së punës për punëtorët që kanë vazhduar punësimin me Ndërmarrjen e Re.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare